

PERMBAJTJA

HYRJE	3
PERMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE	5
GJUHA E URREJTJES.....	7
MEDIA ONLINE NE SHQIPERI.....	9
METODOLOGJIA	12
Formati i monitorimit.....	12
Kampionimi	12
Analiza	13
GJETJET E STUDIMIT	15
ARTIKUJ ME GJUHE TE URREJTJES/SEKSISTE/DISKRIMINUESE.....	15
GRUPET ME TE PREKURA NGA GJUHA E URREJTJES/DISKRIMINIMIT	18
KUSH CITOHE?	22
KARAKTERISTIKA TE SUBJEKTEVE QE JANE VIKTIME E GJUHES SE URREJTJES/DISKRIMINUESE, NE MEDIAN ONLINE	25
KARAKTERISTIKA TE PERGJITHSHME TE ARTIKUJVE ME PERMBAJTJE TE GJUHES SE URRJETJES/DISKRIMINUESE	28
KARAKTERISTIKA TE KOMENTEVE NE ARTIKUJT ME GJUHE TE URREJTJES/DISKRIMINUESE.....	30
BIBLIOGRAFI	35

HYRJE

Raporti ‘Gjuha e urrejtjes dhe diskriminuese në median online në Shqipëri’ paraqet gjetjet e monitorimit në tre media online, me fokus përmbajtjen e gjuhës së urrejtjes, seksiste dhe diskriminuese. Në kuadër të këtij projekti mediat online: Syri.net, Shqiptarja.com dhe Balkanweb, u monitoruan përgjatë periudhës 15 mars – 31 gusht 2020.

Faktor përzgjedhës për këto media ishte së pari popullariteti i tyre në Shqipëri. Sipas të dhënave aktuale të faqes Alexa² (kontrolluar së fundmi në shtator 2020), faqet Balkanweb, Syri.net si dhe Shqiptarja.com renditeshin përkatësisht në vendet 6, 7 dhe 34, të listës prej 50 faqeve më të klikuara në Shqipëri.

Në këtë monitorim janë marrë në shqyrtim të gjitha rubrikat në faqet online të tre mediave të sipërpërmendura.

Qëllimi i këtij projekti është evidentimi i gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese në mediat online, duke u fokusuar në:

Format me të cilat shprehet gjuha e urrejtjes/ diskriminuese,
Grupet më të prekura nga gjuha e urrejtjes/diskriminuese,
Tematikat në të cilat gjuha e urrejtjes/diskriminuese, është më e përhapur,
Karakteristika të lajmeve që kanë gjuhë urrejtje në përmbajtje të tyre (tituj, autorë, etj.),
Karakteristika të personave apo grupeve që janë viktimë e gjuhës së urrejtjes,
Reagimin e audiencës (komentet e lexuesve) në artikujt që përmbajnë gjuhë të urrejtjes/diskriminuese.

Shpresojmë që gjetjet e paraqitura në këtë studim të jenë me vlerë për një sërë institucionesh dhe aktorësh në Shqipëri, të cilët kanë një rol në avancimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen nga diskriminimi për të gjitha grupet në nevojë.

Së pari, shpresojmë që gjetjet e këtij monitorimi do të ndihmojnë drejtuesit dhe profesionistët e mediave online në Shqipëri- gazetarët - për të pasur një të kuptuar më të mirë të ndikimit që puna e tyre e përditshme ka në krijimin e realiteteve sociale për një sërë grupesh në nevojë si gratë, komuniteti LGBTI, emigrantët etj. Gjithashtu do të shpresonin se duke evidentuar disa qasje të profesionistëve të medias online veçanërisht përsa i përket mënyrës së përzgjedhjes së lajmeve që përmbajnë gjuhë të urrejtjes apo diskriminuese, do të rrisim ndërgjegjësimin e tyre,

² <https://www.alexa.com/topsites/countries/AL>

për përmirësimin e këtyre praktikave, rritjen e cilësisë së informacionit që ofrohet dhe shmangien e përdorimit të gjuhës së urrejtjes apo diskriminuese në media.

Së dyti, shpresojmë që ky raport t'u jap një pamje më të qartë institucioneve në Shqipëri që merren drejtpërdrejtë me çështje të medias dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, apo Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA). Gjetjet e këtij monitorimi mund t'u vijnë në ndihmë këtyre institucioneve, për të pasur evidenca në përmirësimin e kushteve të portretizimit të grupeve në nevojë në media apo fokusimin e përpjekjeve për ato grupe të cilat evidentohen në këtë studim, si më të prekurat nga gjuha e urrejtjes/diskriminimi.

Së treti, ky raport mund t'u vijë në ndihmë të gjitha atyre organizatave joqeveritare të cilat në punën e tyre e vënë fokusin tek mbrojtja e të drejtave të grupeve në nevojë.

Së fundmi, ky raport synon të ndërgjegjësojë publikun dhe përdoruesit e shpeshtë të mediave online, duke rritur njohuritë për çështje të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në media dhe duke i pajisur ata me aftësi konkrete se si të dallojnë dhe shmangin gjuhën e urrejtjes në media. Për këtë qëllim, gjatë gjithë këtij raporti, gjuha e përdorur do të jetë sa më e kuptueshme dhe praktike, për të gjithë lexuesit.

PERMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

- Û 293 artikuj të monitoruar në tre mediat online, përmbajnë gjuhë të urrejtjes/seksiste/diskriminimit (monitorimi i vitit 2018 evidentoi 212 artikuj në 4 media online).
- Û Ka një rritje të konsiderueshme në numrin e artikujve me gjuhë seksiste, në të gjitha mediat e monitoruara.
- Û Rubrika me përqindjen më të lartë të përdorimit të gjuhës së urrejtjes/seksiste/diskriminuese është rubrika Argëtim- 27.6%.
- Û Kategoria e dytë e artikujve që kanë më shumë përmbajtje të gjuhës së urrejtjes seksiste/diskriminuese është Kuriozitete- 24.9 %.
- Û Të dyja këto kategori përfshijnë lajme për personazhe të showbizz- kryesisht modele- dhe kanë një përdorim të theksuar të fotove dhe titujve sensacionale, me fokus objektifikimin e personazheve dhe seksualizimin e përmbajtjes mediatike.
- Û Rubrika e tretë me përmbajtje më të madhe të gjuhës së urrejtjes/diskriminimit është Politikë/Ligje/Qeverisje- 15.1 %.
- Û Shumica e gjuhës së urrejtjes për këtë kategori gjendet në komentet e lexuesve, 'të nxitur' edhe nga mënyra e formulimit të titujve dhe lajmeve që përfshijnë personazhe kryesorë të politikës shqiptare.
- Û Gratë, përbëjnë grupin më të madh të prekur nga gjuha e urrejtjes/seksiste/diskriminuese me 68.9 % të artikujve. Përqindja e artikujve me gjuhë seksiste dhe diskriminuese përdorur daj grave në median online, shënon një dyfishim nga monitorimi i mëparshëm (2018- artikujt ndaj grave përbënin 38% të totalit të artikujve).
- Û Gjuha e përdorur ndaj grave në media në më të shumtën e rasteve, lidhet me objektifikimin dhe seksualizimin e tyre, duke i mëshuar fotove dhe duke përdorur tituj sensacional me natyrë të nënkuptuar seksuale (shembuj në këtë studim, faqe 18)
- Û Gjuha e urrejtjes/diskriminuese ndaj grave në media, i referohet në shumicën e rasteve, një karakteristike të grave ose grupit, pra dëmtton gratë si grup shoqëror dhe jo persona të veçantë.
- Û Grupi i dytë më i prekur në median shqiptare nga gjuha e urrejtjes janë vetë shqiptarët- %.
- Û Shumica e gjuhës së urrejtjes ndaj shqiptarëve janë marrë nga komentet e lexuesve nëpër artikuj të ndryshëm, ku komentuesit shprehin gjuhë të urrejtjes ndaj njëri- tjetrit apo

shqiptarëve të Kosovës, por duke e identifikuar ‘tjetrin’ me një grup të një përkatësie të ndryshme vendore, sociale, ekonomike, etj.

- Ü Ndërkohë komuniteti LGBTI, është i targetuar me gjuhë të urrejtjes/diskriminuese në 2.7% të artikujve. Sërish, shumica e gjuhës së urrejtjes lidhet me komente te lexuesve edhe nëse lajmet nuk kane lidhje me këtë komunitet, por përdoren terma si: pederast; b..q*r etj, për të denigruar figura publike.
- Ü Në lajmet me gjuhë të urrejtjes për komunitetin LGBTI, pothuajse të gjithë artikujt apo gjuha e urrejtjes i referohet personave gay.
- Ü Më të cituarit me përdorim të gjuhës së urrejtjes në median online janë gazetarët që fabrikojnë lajme për personazhet e showbiz-it dhe komentuesit, me anë të komenteve në fund të lajmit.
- Ü Vetëm në 1 rast nga 293 artikuj në total ka një burim në lajm që kundërshton gjuhën e urrejtjes. Burimi që kundërshton është personi i prekur drejtperdrejtë nga gjuha e urrejtjes/diskriminimi dhe kundërshtimi nuk është deklaratë zyrtare por postim ne mediat sociale.
- Ü Grupmosha më e prekur nga gjuha e urrejtjes/diskriminimi ndryshon sipas gjinisë. Kështu për gratë grupmosha më e prekur është 19-25 vjeç.
- Ü Kategoritë e gjuhës së urrejtjes më të përdorura në median online rezultojnë të jenë:
 - Metafora dehumanizuese
 - Gjuhë që përkrah dhe nxit dhunën
 - Gjuhë përçarëse
- Ü Në 190 artikuj jepen disa elemente identifikues për viktimat e gjuhës së urrejtjes/seksite/diskriminuese (emir, mbiemri, foto, mosha etj). Ndërsa në 46 artikuj jepet emir dhe mbiemri
- Ü Në 243 artikuj, ka foto reale të subjekteve që jnë target për gjuhën e urrejtjes, seksiste, diskriminuese.
- Ü Në 204 artikuj, ka përdorim të gjuhës së urrejtjes/seksiste/diskriminuese, në titull.
- Ü Vetëm 17 artikuj nga 293 në total, kanë autor të shkrimit.
- Ü Të gjithë artikujt me gjuhë të urrejtjes/diskriminuese dhe që kanë komente, kanë përdorim të gjuhës së urrejtjes edhe në komente.
- Ü Të gjithë komentet me përdorim të gjuhës së urrejtjes/diskriminimit, janë të pafshirë- në të njëjtën gjendje- edhe disa ditë pas postimit.

GJUHA E URREJTJES

Termi Gjuhë e Urrejtjes është një term relativisht i ri në legjislacionin ndërkombëtar. Në mënyrë eksplicite ai përmendet vetëm në disa raste. Një nga këto dokumente është Rekomandimi (97) 20, i Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare të Këshillit të Europës, i cili është miratuar në 30 tetor 1997. Në këtë dokument gjuha e urrejtjes është përcaktuar si:

... gjuhë e cila mbulon të gjitha format e shprehjes të cilat shpërndajnë, nxisin, promovojnë apo justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, anti-Semitizmin, apo format e tjera të urrejtjes bazuar në intolerancë, që përfshin: intolerancën e shprehur në qëndrime agresive nacionaliste dhe etnocentriste, diskriminim dhe armiqësi kundrejt minoriteteve, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante.

Siç është përshkruar këtu gjuha e urrejtjes i referohet me tepër çështjeve të racës, etnicitetit dhe intolerancës ndaj grupeve të ndryshme. E njëjtja gjë vlen edhe për dokumenta të tjerë ligjorë siç janë Konventa Ndërkombëtare për të drejtat Politike dhe Civile (ICCPR), e cila nga shumë aktorë shihet si një nga dokumentat më të rëndësishëm dhe domethënës për sa i takon gjuhës së urrejtjes (Gagliardone et.al, 2015) duke qenë se përfshin artikullin 19, me një fokus të veçantë në të drejtën e shprehjes. Ky nen thekson që:

Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të marrë, kërkuar dhe pasur informacion dhe ide të të gjitha llojeve, pa dallim barrierash, nëpërmjet të shkruarit, gojarisht, ose të shtypura, në formën e artit, apo nëpërmjet çdo kanali, medie dhe forme që duan.

Në pikën 20/2 të këtij neni, thuhet se:

Çdo lloj advokacie me natyrë të urrejtjes nacionaliste, raciale apo religjioze e cila çon në nxitjen e diskriminimit, armiqësisë apo dhunës, ndalohet me ligj.

Sërish edhe në këtë dokument vetëm raca, kombësia apo feja identifikohen si kategori dhe subjekte për gjuhën e urrejtjes. Kategori të tjera sociale nuk janë të përmendura dhe nuk janë të adresuara drejtpërdrejtë në këtë dokument të rëndësishëm. Një nga këto kategori është gjinia (shih Bartow, 2009). Duhet thënë se edhe mekanizmat ligjorë ndërkombëtarë që kanë në fokus të tyre gratë- siç është Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundrejt Grave (CEDAW) – nuk e përmendin gjuhën e urrejtjes në mënyrë eksplicite.

“Ndërkohë, gjuha e urrejtjes vazhdon të përdoret gjerësisht në diskursin e përditshëm si një term i zakonshëm...” (Gagliardone et al., 2015:7).

Një sërë projektesh kërkimore mbi gratë dhe median kanë bërë thirrje për një vëmendje më të shtuar të gjuhës seksiste në media dhe nevojës për ta kategorizuar atë si gjuhë të urrejtjes (shih Simona et al, 2019; Bartow 2009; Lillian, 2007). Projekte të tjera kërkimore, janë munduar të paraqesin evidenca sasiore dhe cilësore të ngacmimeve që iu bëhen grave dhe vajzave në mediat online (see Erjavec & Kovacic 2012). Në Shqipëri, në kuadër të këtij projekti të zbatuar gjatë vitit 2018, u hartua për herë të parë një studim më të dhëna tre- mujore, për gjuhën e urrejtjes në mediat online në Shqipëri (shih Kaziaj, 2018). Në shumicën e rasteve, hartimi i një studimi të tillë paraqet vështirësi të mëdha (Bartow, 2009). Këto lidhen me faktin se nuk ka një përkufizim të gjithëpranuar mbi gjuhën e urrejtjes dhe për më tepër, nuk ka një dakordësim në nivel ndërkombëtar për kriteret të cilat duhet të plotësojë një tekst apo shprehje për t’u kategorizuar si gjuhë e urrejtjes. Siç shprehet edhe Stellar “duke marrë parasysh këto vështirësi, nuk është habi fakti që shumica e studimeve mbi gjuhën e urrejtjes, nuk e nisin punën nga përkufizimi, por nga shembujt konkretë” (Sellars, 2016:15).

MEDIA ONLINE NE SHQIPERI

Sipas Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në Shqipëri, në vitin 2017 numëroheshin 2.16 milion abonentë me akses në internet. Sipas Census-it të fundit, kryer më 2011, popullsia e Shqipërisë ishte 2,8 milion banorë, të ndarë në 722,262 familje³.

Ky numër kaq i lartë aksesit në internet, ka bërë që në Shqipëri të ketë një rritje të madhe të kanaleve online të raportimit, të ashtuquajtura media online. Sipas një raporti të Monitorit të Pronësisë së Medias (Media Ownership Monitor for Albania⁴), në Shqipëri ka më shumë se 650 website lajmesh që operojnë online. Vetëm 62 prej tyre drejtohen nga gazetarë- gjë e cila e vë në pikëpyetje cilësinë e ofruar nga këto 'media'. Një prezencë kaq e lartë e mediave online në një vend kaq të vogël, mund të bëhet shkak për përforsimin e gjuhës së urrjetjes online, duke marrë parasysh edhe faktin që në Shqipëri- ashtu si edhe në vende të tjera- mungojnë mekanizmat e duhur për të monitoruar dhe adresuar përmbajtjen e mediave online.

Gjuha e urrjetjes si përkufizim eksplicit, nuk është bërë ende pjesë e legjislacionit shqiptar. Nga ana tjetër, diskriminimi është subjekt i Ligjit Nr. 10 221 'Për Mbrojtjen nga diskriminimi' miratuar në 2010. Në këtë ligj termi diskriminim është përcaktuar si:

"Diskriminimi" është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji [gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër], që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Gjithashtu neni 265 i Kodit Penal thotë:

³ Ky wshtw Censusi i fundit i kryer nw vendin tonw. Censusi I radhws wshtw planifikuar pwr kwtw vit, por nuk kanw dalw ende rezultatet.

⁴ Reporti mund tw lexohet kwtu: <http://albania.mom-rsf.org/en/>

ÁNxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjetë

Fraza ‘...shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë ...’ mund të konsiderohet përfshirëse e medias online gjithashtu, por deri tani nuk ka pasur ndonjë rast publik për përdorimin e ketyrë neneve kundrejt medias (Londo, 2014).

Ndoshta politika më relevante për t’u përmendur këtu dhe që lidhet me diskriminim e grave është Ligji për Barazinë Gjinore në Shqipëri⁵, i cili është miratuar në vitin 2008. Neni 26 i këtij ligji, i cili i referohet barazisë gjinore në media, shprehet se:

Media ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe të meshkujve: a) përmes raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore; b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor; c) përmes shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet. 2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njërës prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

Siç edhe në legjislacione të tjera, nuk është e përcaktuar as në këtë ligj nëse termi media përfshin edhe mediat online. Gjithsesi neni 26/2, është me rëndësi të madhe në këtë rast pasi adreson gjuhën e urrejtjes ndaj grave, në media. Duke qenë se shumica e përmbajtjes në mediat online është plagjiaturë e mediave tradicionale, kryesisht atyre televizive, në Shqipëri- sic raportohet në Media Ownership Monitor (2019), në mënyrë të tërthortë, ky nen adreson edhe këtë çështje.

Siç përshkruhet në raportet mbi median në Shqipëri (shih Londo, 2014; Dizdari, 2013) nuk ka një mekanizëm që të adresojë gjuhën e urrejtjes në media. Për më tepër, në një raport të hartuar mbi këtë temë Londo (2014), përshkruan disa raste të cilat janë referuar dhe trajtuar nga Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi- i cili është institucioni përgjegjës për monitorimin e implementimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, i cituar më sipër. Asnjë nga këto raste nuk lidhet me të drejtat e grave apo çështje të diskriminimit gjinor (lexo faqet 25 dhe 26 të raportit të cituar).

Studimet dhe kërkimet mbi median në Shqipëri apo tema si gjuha e urrejtjes, janë më së shumti të fokusuara tek mediat tradicionale siç janë televizionet⁶. Kjo edhe për shkak se mediat audiovizive janë subjekt i kontrollit nga Autoriteti i Mediave në Shqipëri. Media online është lënë mënjanë përse i përket këtyre studimeve. Por, reputacioni dhe ndikimi në rritje i mediave

⁵ http://www.mod.gov.al/images/PDF/barazia_gjinore_shoqeri.pdf

⁶ <http://ama.gov.al/wp-content/uploads/2019/09/HATE-SPEECH-1.pdf>

online në Shqipëri, sidomos këto vitet e fundit, si dhe debatet e vazhdueshme për nevojën e rregullimit të këtij sektori mediatik, bëjnë që nevoja për të eksploruar praktikat gazetarske në këto meduime dhe për të hedhur dritë mbi ndikimin që kanë këto media në përforcimin e gjuhës së urrejtjes apo diskriminimit, të shihet më përparësi, si masë për të hartuar politika dhe mjete efikase monitorimi dhe për të adresuar këtë çështje kaq serioze.

METODOLOGJIA

Formati i monitorimit

Formati i monitorimit dhe kodimi i termave i përdorur në këtë studim është hartuar specifikisht për mediat online në Shqipëri. Si bazë për hartimin e këtij formati⁷ ka shërbyer formati i përdorur nga autori i këtij raporti për monitorimin e lajmeve mbi çështje të fëmijëve në median shqiptare, si pjesë e projektit të tij të doktoraturës në Universitetin e Ghentit, Belgjikë (2013-2016) (shiko Kaziaj, 2018, 2017, 2016). Për më tepër formati është pasuruar edhe me elementë nga formate të mëparshme të përdorura nga *Historia ime* me qëllim monitorimin e medias në Shqipëri.

Formati i monitorimit përbëhet nga katër pjesë kryesore. Në pjesën e parë përfshihen informacionet bazë për median dhe karakteristika të artikullit që po monitorohet (media, data, titulli, seksioni, tematika, etj). Në pjesën e dytë përfshihen elementë dhe karakteristika të përgjithshme për personat/grupet që janë vitimë e gjuhës së urrejtjes dhe zërat/individët që citohen në artikull. Pjesa e tretë përmban elementë të detajuar për subjektet që janë viktimë e gjuhës së urrejtjes (gjinia, mosha, grupi, pozicionimi në lajm, element identifikues etj). Ndërkohë pjesa e fundit- e cila vjen si një risi në monitorimin e medias online- ka të bëjë me një analizë të komenteve nga lexuesit.

Përpara nisjes së procesit të monitorimit, u krye një trajnim një ditor nga eksperti i këtij projekti me monitorueset: Edlira Mara, Alba Ahmetaj dhe Ajtena Muraku më qëllim përvetësimin e procesit të monitorimit. Gjithashtu, monitorueset patën një javë prove gjatë së cilës patën mundësi të praktikonin njohuritë për monitorimin dhe sqarimin e çështjeve problematike.

Kampionimi

Pjesë e këtij studimi janë bërë ata artikuj të cilët përmbushin një ose disa nga kriteret e mëposhtme:

- kanë përdorim të gjuhës së urrejtjes në titull,
- kanë përdorim të gjuhës së urrejtjes në përmbajtje të artikullit,

⁷ Format i monitorimit mund të merret nga autori me kërkesë në dresën e tij elektronike: emiljanokaziaj@gmail.com.

- kanë përdorim të gjuhës së urrejtjes në fotografitë apo videot që shoqërojnë artikujt,
- kanë përdorim të gjuhës së urrejtjes në komentet që shoqërojnë artikullin.

Bazuar në këtë përzgjedhje si dhe në gjetjet nga monitorime të mëparshme të bëra për këtë qëllim (shiko raportet e gjetjeve të monitorimit nga publikimet e Historia Ime, 2015, 2016, 2017, 2018) ky studim fokusohet në përdorimin e gjuhës së urrejtjes, veçanërisht për këto kategori në Shqipëri:

- ☐ Gratë
- ☐ Fëmijët
- ☐ Komuniteti Rom
- ☐ Komuniteti Egjiptian
- ☐ Komuniteti LGBTI
- ☐ Emigrantët
- ☐ Komunitetet/besimet fetare
- ☐ Personat me aftësi të kufizuara
- ☐ Pakicat kombëtare

Analiza

Për analizimin e të dhënave të mbledhura nga procesi i monitorimit është përdorur një kombinim i analizës cilësore dhe sasore të të dhënave. Gjetjet sasore janë pasuruar më tej me një analizë cilësore të të dhënave duke u fokusuar tek shembujt konkretë nga lajmet në mediat online.

Në këtë studim, analiza e të dhënave i ushtrohet metodës për analizën e përmbajtjes mediatike, siç sugjerohet nga Krippendorff (2004). Sipas tij “studiuesit që përdorin analizë të përmbajtjes (mediatike) duhet të vëzhgojnë nëse praktikatat e komunikimit sjellin qasje të reja, përforcojnë atë çka tashmë dihet, nëpërmjet përsëritjes, apo zbehin qasje në komunikim duke mos i bërë ato të dukshme” (p. 72). Në rastin e gjuhës së urrejtjes në mediat online, zgjedhja për të përdorur metodat sasore dhe cilësore në analizimin e përmbajtjes mediatike, ofron një mundësi shumë të mirë për të vëzhguar dhe zbulur se cilat janë ato konstrukte narrative që përdoren më shpesh në mediat online si gjuhë urrejtje dhe cilat grupe janë më të përkrahura prej saj. Për më tepër pasja e të dhënave sasore na bën të mundur për të krahasuar edhe mediat online ndërmjet tyre dhe për të parë nëse ka ndonjë ndryshim thelbësor në mënyrën se si këto media e servirin informacionin.

Një vëmendje të theksuar në analizë do të marrë edhe gazetari apo autori i lajmit. Sipas Krippendorff, (2004) karakteristikat që i vishen një grupi të caktuar në media, apo mënyra se si flitet për ta tregon, ndër të tjera, mendimet që kanë për këtë grup, edhe prodhuesit e lajmeve,

konsumuesit e lajmeve apo mendimin e përbashkët të tyre, të çimentuar në një kulturë të caktuar. Pra, përdorimi i gjuhës së urrejtjes në median online, mund të merret edhe si një shenjë e ekzistencës së diskriminimit në shoqëri për ato grupe, që janë më shpesh viktime të gjuhës së urrejtjes. Në të njëjtën linjë, Richardson (2007:49) shprehet se “mënyra se si aktorë të ndryshëm social emërtohen në media, tregon jo vetëm grupin në të cilin ata bëjnë pjesë por edhe marrëdhënien që ekziston mes atyre që emërtohen dhe atyre që emërtojnë”.


Për pjesën sasiore të analizës është përdorur programi statistikor SPSS Statistics 21.

GJETJET E STUDIMIT

ARTIKUJ ME GJUHE TE URREJTJES/SEKSISTE/DISKRIMINUESE

Në total për këtë studim janë monitoruar të gjithë artikujt e publikuar në tre mediat online Syri.net, Balkanweb.com dhe Shqiptarja.com. Nga këto artikuj 293 u përzgjedhën për analizë si artikuj që përmbajnë gjuhë të urrejtjes/seksiste/diskriminuese, sipas përcakimit të qartësuar në metodologjinë e këtij studimi.

Kjo shifër, siç do ta analizojmë edhe pak më poshtë tregon për një zvogëlim të gjuhës së urrejtjes në mediat online në Shqipëri, në krahasim me studimet e kryera më herët për këtë qëllim por një rritje të numrit të artikujve me gjuhë seksiste dhe diskriminuese, sidomos për gratë, në Shqipëri. Gjithsesi numri i artikujve siç paraqitet në grafikun 1.1, duhet të konsiderohet shqetësues për cilësinë e medias online në vendin tonë.




Grafiku 1.1.

Në grafikun 1.1, paraqiten artikujt me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes/seksiste/diskriminuese, sipas mediave online të monitoruara.

Sipas këtij grafiku, media që përmban më shumë artikuj me gjuhë të urrejtjes është Shqiptarja.com. Siç do të shpjegohet edhe në gjetjet e tjera, fakti që kjo media i kushton një rëndësi të madhe rubrikave të showbiz dhe lifestyle, me orientimin në skandalet e të

ashtuquajturve VIP, si dhe prania e mundësisë për të komentuar nga lexuesit, janë dy nga faktorët që ndikojnë në rritjen e përmbajtjes me gjuhë të urrejtjes në lajme.



Grafiku 1.2.

Siç shihet në grafikun 1.2, tre kategori kanë përqindjen më të lartë me përmbajtje të gjuhës së urrejtjes/seksiste/diskriminuese: **Argëtim- 27.6%; Kuriozitete- 24.9 % dhe Politikë/Qeverisje/Ligje- 18.1%.**

Rubrika me përqindjen më të lartë, Argëtim - 27.6%, është një gjetje e re, krahasuar me raportet e mëparshme, të cilat kanë nxjerrë rubrikën Art, Media, Kulturë si rubrikën me më shumë artikuj me gjuhë të urrejtjes. Gjithsesi, në këtë rubrikë ka një sërë lajmesh të cilët janë lajme të ‘fabrikua’ nga gazetarët që mbulojnë këtë fushë apo vetë personazhet e showbiz, më qëllimin për të bërë ‘lajm’. Duke dashur të tërheqin sa më shumë lexues dhe komentues, titujt e këtyre lajmeve përmbajnë terma të gjuhës së urrejtjes/gjuhës seksiste apo diskriminuese, të fabrikua nga gazetarët në foren e një lajmi, detajet e cileve thjesht merren dhe kopjohen nga rrjetet sociale të vetë personazheve. Disa shembuj të këtyre lajmeve janë:


ΨYdzāK LJ2 Š ÎKōff2}2y'90I- tI-Řf2Ö}lyKQ- Syri.net, 09.06.2020

Ψ I lIjā FI-ŊIŠΦ CŊI- yŌŠā}I- āKFI- lIjŠŪ YŠ ūŠ ōŊIŠyŘāKYŠ ŘKŠ yŌz} λ tŠ ŌŠyŘ λ YI-ΞŊIyI-ūŠāŋ- Balkanweb, 02.07.2020

ΨKengetarja shqiptare provokon ndjekesit me kete imazh-Syri.net, 27.05.2020

Ψ tI- ŊIŠŌLJŠŪI- ŘKŠ YŠ ŘdzI-ŊIŪ yŠ ΦΦ9ŊI- LăŭŊIŠŤA LJ2ÎI- āŠ}āŋQ- Balkanweb, 03.08.2020

GRUPET ME TE PREKURA NGA GJUHA E URRJETJES/DISKRIMINIMIT



Grafiku 2.1.

Grafiku 2.1, paraqet në përqindje, grupet më të prekura në median online nga gjuha e urrejtjes/diskriminimit.

Gratë, përbëjnë grupin më të madh të prekura nga gjuha e urrejtjes/diskriminimi me afërsisht 69% të artikujve. Kjo është një rritje e konsiderueshme krahasuar me studimet e mëparshme kur gratë ishin target për rreth 39% të artikujve. Ky është një fakt shumë shqetësues. Edhe pse nuk mund të tregohet një lidhje e drejtpërdrejtë e gjuhës së urrejtjes në media, me nivelin e dhunës në shoqëri, përsëri, këto dy elementë janë tregues të ndërsjelltë të njëri-tjetrit. Një nivel i lartë i gjuhës së urrejtjes në media për një grup të caktuar, mund të merret si indikator i ekzistencës së diskriminimit për atë grup në një shoqëri të caktuar. Siç e kemi përmendur më sipër, emërtimi apo gjuha që përdoret kundër një grupi të caktuar mund të merret si indikator i besimeve të publikut apo prodhuesve të lajmeve për atë grup. Rrjedhimisht, fakti që gratë shikohen si target më i madh për gjuhën e urrejtjes/seksiste/diskriminuese, në Shqipëri, është indikator i gjendjes me të cilën ky grup përballet në shoqëri.

Gjatë dy viteve të fundit, 17 gra janë raportuar në media si viktime, të vrara bashkëshortët, baballarët apo vëllezërit e tyre. Nuk duam të themi me këtë që gjuha e urrejtjes në media ka ndikuar drejtpërdrejtë në këtë situatë, apo në këto situatë specifike. Por ajo që sugjerohet është që të dy fenomenet nuk duhen parë si të shkëputur nga njëri-tjetri.

Gjuha e përdorur ndaj grave në media ka disa tipare. Në më të shumtën e rasteve, kjo gjuhë është hapur gjuhë seksiste/diskrimini që lidhet me ‘mungesën e ndershmërisë’ së femrave, duke i mëshuar termave denigrues për grate dhe vajzat dhe duke i objektifikuar ato. Ja disa nga shembujt:

ΨΥΚΙΣΤΗΣ ΝΑΥΑ ΟΣΙΣΥ ΥΨΙΣ ΙΣΥΟΣΙΣ ΛΙΣΙΝΙΣΙΣΙΣ- Syri.net, 31.03.2020

Ψ Ι ΛΙΑ ὀδζ ΙδζΙΖάΚΣά άΙ· γδζ Ι Ά ΡΖά Εδζ Ιά ΙΣΙΝΙΣΙΣ ὀδζ ΙΣά- 14.04.2020

